




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
Kryetari i Komunës



Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr.110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për lejimin e udhëtimit të shërbyesve civilë të Komunës së Prishtinës në Republikën e Shqipërisë.
- II. Për udhëtimin e cekur në pikën I të këtij vendimi, ndahet shuma prej 5.000 (pesë mijë) €, nga kategoria e subvencioneve.
- III. Mjetet e cekura në pikën II të këtij vendimi, do të shpenzohen për akomodim, fjetje, mëngjes, drekë dhe darkë.
- IV. Transportin për udhëtim të cekur në pikën I të këtij vendimi, do të sigurojë Këshilli organizativ, me mjetet e siguruara nga participimi i shërbyesve civilë pjesëmarrës në ekskursion.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Drejtorisë së Financave,
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Këshillit organizativ,
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS

Shpend Ahmeti

